



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME  
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës  
Kancelarija Predsednika Opštine/Mayor's Office

Nr. 02/955  
Datë: 30/10/2023

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ( Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008), duke u bazuar në nenin 36 të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik Nr. 08/L-196, në zbatim të Rregullorës (QRK) Nr. 07/2023 për Kompensim për Kujdestari, Punën gjatë Natës dhe Punën jashtë Orarit të Rregullt të Punës, të kërkesë së Agjencisë së Menaxhimit Emergjent Nr. 82/2, të datës 21.06.2023, dhe Vendimit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, Nr. 50/2023, të datës 18.10.2023, në pajtim me nenin 54 të Statutit të Komunës së Shtimes 01Nr. 06/1636, të datës: 03.09.2008, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

### V E N D I M

- 1) Lejohet pagesa për kompensim për kujdestari, punën gjatë orarit të natës, jashtë orarit të rregullt të punës, gjatë ditëve të festave zyrtare dhe gjatë fundjavëve për punonjësit e Njesisë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim (NJPZSH)-Shtime.
- 2) Pagesa e kompensimit nga pika 1 e këtij vendimi duhet të bëhet nga muaji Janar 2023 për vitin përkatës fiskal dhe realizohet sipas dispozitave të nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.
- 3) Kushtet, rregullat dhe procedurat e kompensimit, parashihen në Rregullorën Nr. 07/2023 për kompensimin për kujdestari, punën gjatë orarit të natës, jashtë orarit të rregullt të punës, gjatë ditëve të festave zyrtare dhe gjatë fundjavës, si dhe në Vendimin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve Nr. 50/2023, të datës 18.10.2023.
- 4) **Ngarkohen Njësia e Burimeve Njerëzore, Sektori i Financave ( Zyrtari Kryesor Financiar, Shefja për Buxhet) dhe institucionet përkatëse për zbatimin e plotë të këtij vendimi.**
- 5) Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Iu dërgohet:

- Njesisë për Burime Njerëzore
- Zyrtarit Kryesor Financiar
- Njesisë Profesionale për Zjarrfikje dhe Shpëtim (NJZPSH)-Shtime

